

SHKUPI

LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT

NUMËR PA
PAGESE

СКОПЈЕ

Numër 2 Viti I 31.12.2008

Propozim Buxheti për 2009

**PARATË E QYTETARËVE
– PËR QYTETARËT**



TRAMVAJI BËHET REALITET



“SHKUPI”

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
“Shkupi” u botua më
10 dhjetor 2008

Del çdo të mërkurë të tretë të
muajit

Kryeredaktor
Ljupço Pandilovski

Zëvendës kryeredaktor
Nafie Selmani

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografisë
Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektorë
Behar Dalipi
Merita Abdullahi
Sadije Dalipi
Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni: REPRINT



Të nderuar qytetarë të Shkupit,

Jemi në prag të Vitit të Ri 2009. Tani më kemi filluar me festimet, të cilat për një çast, së paku, duhet ti largojnë mendimet tona prej brengave të përditshme dhe përmes një ambienti dhe disponimi festiv do të mundësojnë që të fokusohemi drejtë një ardhmërie më të mirë për të gjithë ne.

Viti që po e lëmë pas na solli shumë projekte të reja, siç është pika lidhëse afër hotelit “Kontinental”, zhardineritë përgjatë bulevardëve dhe shumë projekte të tjera nga fusha e veprimtarive komunale, urbanizmit, komunikacionit... Qyteti i Shkupit prej burimeve të saja financiare përtëriu një pjesë të mekanizimit të ndërmarrjeve publike “Rrugët dhe rrugicat” dhe “Parqet dhe gjelbërimet”. Gjithashtu vazhdimësi përjetojnë edhe manifestimet e qytetit të cilat e fisnikëruan jetën kulturore të kryeqytetit tonë gjatë katër viteve të kaluara.

Kur flas për vazhdimësinë, vitin e ardhshëm do të fillojë me realizimin e projektit të cilin e përgatisim pothuajse tre vite. Gjithsesi, bëhet fjalë për tramvajin, i cili për qytetarët e Shkupit do të bëhet një realitet. Po vazhdojmë me rregullimet përfundimtare të Kopshtit zoologjik, kurse

për NQP sërish do të ndajmë subvencione prej 129 milionë denarë, sikur që bëmë edhe gjatë vitit që po kalon.

projeksionet buxhetore për vitin e ardhshëm kanë karakter investues, për arsye se pothuajse 65% të buxhetit para-shikohet që të realizohet për investime kapitale. Përveç kësaj, këtë vit, për herë të parë, Qyteti i Shkupit fiton edhe Buxhetin zhvillimorë, me të cilin në të ardhmen me vazhdimësi do të planifikohen dhe financohen projektet, siç është projekti i tramvajit, rikonstruksioni i tërësishëm i parkut të qytetit, ndërtimi dhe rikonstruksioni i akseve rrugore, mbrojtja e ambientit jetësorë, qendrës për kontrollim dhe menaxhim me komunikacioni dhe përpilimi përfundimtarë i sistemit të tërësishëm gjeografik informatikë / SGJI. Me kënaqësi të veçantë Ju paralajmëroj edhe projektin final ideor për ndërtimin e teleferikut që do të nisët prej Vodnos së Mesme, përmes Kryqit të Mileniumit dhe do të përfundojë në kanjonin Matka. Përkaj projektit për ndërtimin e teleferikut Qyteti do të investojë në rregullimin e mëtutjeshëm të kanjonit Matka me qëllim që të mbrohen bukuritë natyrore por edhe që të revitalizohet jeta e pasur shpirtërore.

Që t’i arrijmë këto qëllime dhe në kënaqësi për të gjithë qytetarët tanë, me këtë ne qytetin e Shkupit do ta numërojmë në listën e metropoleve evropiane, përkaj përpjekjeve të administratës së qytetit, është e domosdoshme që të përkrahet iniciativa jonë për ndërrimin e ligjeve nga ana e pushtetit qendrorë, me këtë do të mundësohet parashtrimi sistematik dhe financimet përkatëse të kompetencave të qytetit.

Të nderuar bashkëqytetarë,

Me Ju po i ndaj shpresat për një të ardhme më të mirë dhe në emër të kësaj Ju dëshiroj shumë fat në Vitin e Ri 2009.

Kryetari i Qyteti të Shkupit
Trifun Kostovski



TRAMVAJI BËHET REALITET



Ndërtimi i depos së tramvajit planifikohet që të fillohet në tre muajt e parë të vitit 2009. Më pas do të ndërtohet një pjesë e linjës të binarëve dhe kur do të krijohen mundësitë do të sillet edhe tramvaji promovues. Sipas asaj që pritet, transporti i rregullt me tramvaj në qytetin e Shkupit do të fillojë në vitin 2010.

Aleksandra Xhaxhovska

Përpjekjet e Kryetarit të Qytetit z. Trifun Kostovski dhe të administratës së qytetit për një lloj të ri të transportit alternativ të udhëtarëve, i cili do të jetë i shpejtë, më ekonomik dhe më ekologjik, filluan ta përjetojnë realizimin e tyre. Projekti i tramvajit fillon të bëhet realitet.

Këto ditë pritet që të përfundojë përgatitja e projektit për depon e tramvajit, i cili do të ndërtohet në hapësirën e Novo Lisiçes dhe lumit Vardar. Pasi të përpilohet dokumentacioni përkatës, do të bëhet revizioni i projektit, dhe pas kësaj Qyteti i Shkupit do të shpall tender për zgjedhjen e realizuesit më të volitshëm që do ta ndërtojë këtë depo.

Tramvaji do të lëviz përgjatë bulevardëve ASNOM, "Srbija" dhe "Jane Sandanski" dhe më pas do të kalojë përkaj Bankës Popullore që të arrijë deri te hoteli "Holidaj In". Prej hotelit do të lakoje në të majtë, në drejtim të Spitalit të qytetit, përkaj Pishinës Olimpikë në drejtim të Bankës Popullore sërish të inkuadrohet në trajektoren e tij dhe

të përfundojë në stacionin fillestar në Novo Lisiçe.

Në fund të tetorit, Qyteti i Shkupit do të nënshkruaj kontratë me grupacionin e përbërë prej dy firmave italiane dhe një firmë maqedonase dhe një bullgare, të cilat gjatë shtatë muajve të ardhëm në faza do ta realizojnë projektin për trajektoren e parë të tramvajit në qytetin e Shkupit, prej Novo Lisiçe deri në qendrën e qytetit dhe prapa.

Kompanitë „Bono Xhankarrllo“ dhe „Aksioma dizajn“ nga qyteti italian Leko, „Proxhekt bilding of transport systems“ nga Sofja dhe firma „Mak 2000“ prej Shkupit, punojnë paralelisht në përpilimin e projektit për këtë depo, punojnë edhe në projektin për ndërtimin e pjesës së parë të linjës, me gjatësi prej tre kilometrave. Pas ndërtimit të projektit për këtë depo edhe për kilometrat e parë të rrjetit të tramvajit, do të realizohet projekti për nëntë kilometrat e mbetura.

Qyteti i Shkupit për përpilimin e tërë projektit veçoi 471 mijë euro nga buxheti i saj.

Për projektin e tramvajit - 500 milionë denarë

Qyteti i Shkupit parashikon 500 milion denarë në Buxhetin për vitin 2009 për ndërtimin e depos për tramvajin dhe 600.000 euro për adaptimin e një pjese të bulevardit "Vidoe Smilevski – Bato", që është e domosdoshme për ndërtimin kilometrave të para të rrjetit të tramvajit. Përveç këtyre mjeteve, Shkupi do të përpiqet që të sigurojë edhe 600 milion denarë kredi prej fondeve evropiane me qëllim të

furnizimit të tramvajeve dhe ndërtimin e tre kilometrave të parë të rrjetit të tramvajit.

Depoja në Novo Lisiçe do të ketë kapacitetin që të mbledhë 40 mjete të tramvajeve dhe gjashtë tramvaje – trena. Në suaza të depos do të ekzistojë pjesa e posaçme për hapësirat administrative, për servisim, për pastrim si dhe trafostacioni. Depoja do të shtrihet në sipërfaqe prej 10 mijë metro katrorë.

- Ndërtimi i kësaj depoje me pajisjet e tërësishme dhe me hapësirat përcjellëse do të kushtojë prej 12 deri më 15 milionë euro. Projekti do të hapë mundësi që depoja të ndërtohet në faza, përkatësisht të ndërtohet me zmadhimin e numrit të tramvajeve. Qyteti i Shkupit në Buxhetin për vitin e ardhshëm ka paraparë 500 milionë denarë për ndërtimin e depos me garazhin, që do të ketë kapacitetin për numër më të vogël të mjeteve transportuese, për arsye se në fillim nuk do të ketë nevojë për një objekt aq të madh, parashikohet që të shfrytëzohen vetëm pesë mjete transportuese. Më pas depoja do të mund të sendërtohet me zgjerimin e rrjetit. Duhet që në mënyrë racionale ti përcaktojmë mjetet financiare që sa më shpejtë të fitojmë transportin e tramvajit – thotë Kryetari Kostovski.

Ndërtimi i objektit planifikohet që të fillojë në tre muajt e parë të vitit 2009. Më pas do të ndërtohet edhe një pjesë e linjës së binarëve dhe kur do të krijohen mundësitë do të sillet edhe tramvaji promovues. Sipas pritjeve, transporti i tramvajit do të mund të shfrytëzohet prej fillimit të vitit 2010.



Trasa e tramvajit-Dispozicioni

EVROPA INVESTON SHUMË MJETE PËR HEKURUDHAT

Hekurudha si sistem i transportit publik të udhëtarëve përjeton një famë të madhe në shtetet evropiane. Mjete të shumta të fondeve evropiane investohen saktë në ndërtimin e sistemeve të tilla, prej tramvajit deri te hekurudhat e shpejta. Tramvaji, si mjet i transportit publik, në krahasim me autobusin është më ekonomik. Tramvaji i standardizuar me gjatësi prej 32 metro ka kapacitet prej 220 deri më 300 udhëtarë, derisa një autobus në dy pjesë ka kapacitet prej 160 udhëtarë. Në krahasim me autobusët solo, tramvaji mund të mbledh tre herë më shumë udhëtarë.

Kompanitë italiane "Bobo Xhan-karollo" dhe "Aksioma dizajn", që janë pjesë grupacionit i cili do të realizojë projektin për linjën e parë të tramvajit në Shkup e kanë projektuar trafikun e tramvajit në më shumë qytete në

shtetet prej ku vinë, në mes të cilave edhe qyteti i Milanos, Palermos, Bresha, Padova dhe Bergamo, ata gjithashtu e kanë përpiluar edhe projekti për një pjesë të hekurudhës nëntokësore në Romë. Drejtori dhe pronari i "Aksioma dizajn" Dario Kominu paralajmëroi se në projektin e qytetit të Shkupit do të shfrytëzojnë përvojën e tyre shumëvjeçare dhe se ai do të jetë projekti më bashkëkohorë që e kanë realizuar.

Qyteti i Shkupit e angazhoi konsultuesin juridik Frank Veindorf i cili do të ndihmojë që të fitohen mjetet financiare prej fondacioneve evropiane që të ndërtohet rrjeti i tramvajit. Sipas tij, më e rëndësishme është që projekti me të cilin aplikohet për fitimin e mjeteve të adaptohet dhe formësohet në pajtim me standardet e BE-së dhe të programeve dhe fondeve.

KRONOLOGJIA E PROJEKTIT PËR TRAMVAJ NË SHKUP

Qyteti i Shkupit dhe Kryetari i qytetit z. Trifun Kostovski gjatë tre viteve të kaluara në mënyrë intensive kanë punuar në përmirësimin e transportit publik urban dhe për gjetjen e transporteve alternative.

Në korrik të vitit të kaluar Qyteti nënshkroi kontratë me firmën "Mak 2000" për përpilimin e studimeve fizibiliteti për transportin makinerik në qytetin e Shkupit, që duhej t'i precizoj trajektorët e mundshme të tramvajit, si dhe arsyeshmërinë ekonomike për implementimin e tij. Administrata e qytet siguroi edhe pozicione stabile financiare, që në masë të konsiderueshme do të ndikojë në rejtingun kreditorë, i cili së bashku me projektin cilësorë do të jetë aduti kryesorë për prezantimin dhe aplikimin për mjetet për ndërtimin e linjës së tramvajit prej fondeve evropiane.

Me studimet fizibiliteti parashikohen katër trajektore të tramvajit në qytetin e Shkupit. Trajektorja e parë do të shtrihet prej urës në Saraj deri në Novo Lisiçë, trajektorja e dytë do të shtrihet përgjatë Bulevardit jugor dhe përmes lidhjes me linjën hekurudhore do të bëhet një unazë qarkore rreth qytetit. Trajektorja e tretë do t'i lidhë vendbanimin Kisella Voda me bulevardin "Bosna dhe Hercegovina" në Butel, kurse trajektorja e katërt përgjatë bulevardit "Partizanski Odredi" dhe do të arrij deri te vendbanimi Çento.



Linja për mirëmbajtjen e kontakteve elektrike në deponë në Nirnberg

KRYETARI KOSTOVSKI E VIZITOI KONZORCIUMIN RAJONAL NË MADRID

Kryetari Trifun Kostovski, gjatë vizitës punuese dyditore në Mbretërinë e Spanjës, e vizitoi Konzorciumin rajonal në Madrid, ku pati mundësi që të njohet me sistemin e menaxhimit dhe kontrollimit të metrove, hekurudhave të lehta, tramvajit dhe transportit urban dhe privat të autobusëve.

Konzorciumi është i themeluar në vitin 1985, dhe ka filluar që të funksionojë si rezultat i nevojës për koordinim të ndërmarrjeve publike dhe private, me qëllim të zmadhimit të cilësisë së shërbimeve në shërbimin publik. Ky Konzorcium ushtron aktivitete në 176 komuna të cilat i takojnë Rajonit të Madridit, në të cilin jetojnë rreth gjashtë milionë banorë. Metroja në Madrid është nën kompetenca të komunës së Madridit dhe të Rajonit të Madridit, autobusët urban janë nën kompetenca të komunës së Madridit kurse transporti hekurudhor është në kompetenca të qeverisë kombëtare.

Delegacioni i Qytetit të Shkupit, i udhëhequr prej Kryetarit të Qytetit z. Trifun Kostovski, pati mundësinë që ta vizitoj ndërmarrjen publike "Metro de Madrid", ku u prezantua mënyra në të cilën funksionon metroja në kryeqendrën spanjolle, e cila u ndërtua në vitin 1919. Metroja e qytetit të Madridit

është në zhvillim dhe modernizim të vazhdueshëm, në pajtim me zhvillimin ekonomik të Madridit dhe të rajonit. Kompetencat mbi metronë e qytetit të Madridit janë të ndara në mes pushtetit lokal dhe atë rajonal (75% është nën kompetenca të Këshillit të Madridit dhe 35 % në kompetenca të Rajonit).

Metroja si një lloj i transportit të shpejtë urban, shfrytëzohet prej 76% të banorëve të rajonit dhe mbulon rrjetin prej 284 kilometrave. Metroja e bashkon qytetin e Madridit me komunat tjera të rajonit, kurse suksesi i funksionimit të metrosë është rezultat i lidhjes së shkëlqyeshme të stacioneve të metrosë me stacionet e autobusëve dhe të stacioneve hekurudhore, përkrahja permanente që kjo ndërmarrje e fiton prej qeverisë kombëtare dhe ekipi i shkëlqyeshëm i menaxhimit.

Delegacioni i Qytetit të Shkupit e vizitoi edhe qendrën për menaxhim të transportit hekurudhor (metroja dhe tramvaji) në qytetin e Madridit. Bëhet fjalë për ndërtimin më modern që gjendet në dy kate nën tokë dhe e cila e kontrollon tërë sistemin hekurudhorë nëntokësorë dhe mbitokësorë.

Gjatë qëndrimit në qytetin spanjoll të Saragosës, delegacioni i Qytetit të

Shkupit e vizitoi uzinën CAF që paraqet një kompani ndërkombëtare për dizajnim, prodhim dhe mirëmbajtjen e vagonëve dhe komponentëve të sistemit hekurudhor. Kjo uzinë prodhon vagonë për të gjitha llojet e mjeteve që lëvizin në binarë, prej tramvajeve deri te trenat shumë të shpejtë që lëvizin me shpejtësi më të madhe se 300 kilometra në orë.

Delegacioni i Qytetit të Shkupit pati mundësinë që të shohë tramvajin më të ri i cili ishte i prodhuar nga kjo uzinë. Ai lëviz me ndihmën e baterive elektrike. Në bazë të kontakteve të realizuara me Këshillin e komunës së Madridit dhe me ndërmarrjet për transport publik, Qyteti i Shkupit pret që së shpejti të realizojë bashkëpunim në fushën e transportit publik.

Përfaqësuesit e firmës IDOM dhe SICE, projektuesit dhe mbikëqyrësit e ndërtimit të metrosë dhe të hekurudhave të lehta/tramvajit në qytetin e Madridit, së shpejti do të vizitojnë qytetin e Shkupit që të bëjnë revizionin e projektit për tramvajin në qytetin e Shkupit por edhe do t'i shqyrtojnë mundësitë për financimin e ndërtimit të rrjetit të tramvajit.

A.XH.



Propozim Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2009

PARATË E QYTETARËVE – PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE ME TË CILAT BALLAFAQOHEN QYTETARËT

Ljupço Pandillovski

Kryetari i Qytetit të Shkupit, z. Trifun Kostovski deri te Këshilli i Qytetit të Shkupit e dorëzoi Propozim Buxhetin e Qytetit për vitin 2009. Të ardhurat e Qytetit për vitin e ardhshëm parashikohet që të arrijnë shumën prej rreth 3,172 miliardë denarë, përkatësisht rreth 50 milionë euro, në buxhetin themelor, prej të cilave 62,9 % janë të parapara për investime kapitale. Kjo do të thotë se Buxheti i vitit të ardhshëm i ruan karakteristikat e tre viteve të mëparshme, dhe kjo është pjesa dominuese e mjeteve të investohen në investimet kapitale, përkatësisht për projektet me të cilat Qyteti në mënyrë afatgjatë zgjidh probleme në fushën e komunikacionit, punëve komunale, planifikimin dhe rregullimin e hapësirës, mbrojtjen e ambientit jetësorë por edhe për financim të vazhdueshëm dhe të sigurt në fushën e kulturës, arsimit, në fushën sociale dhe përmbajtjeve argëtuese – rekreative.

Mjetet në Propozim – buxhetin në pjesën e investimeve kapitale janë të shpërndara në zërat vijues:

NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE DHE URAVE - 526.000.000 DENARË

- Projekte për rrugët - 28.000.000 denarë
- Ndërtimi i rrugëve - 174.000.000 denarë
- Përfundimi i ndërtimit të bulevardit "Vidoe Smilevski Bato" në rrugën Vollkovë, ndërtimi i trotuareve, në bulevardin Srbija – faza e tretë, në bulevardin "Makedonska vojska" – faza e parë dhe e dytë dhe në bulevardin "Mitropolit Teodosil Golloganov" – faza e parë.

RIKONSTRUKTIMI I RRUGËVE - 270.000.000 DENARË

- Zgjerimi i rrugës – Prvomajska, rikonstruktimi i udhëkryqeve dhe stacioneve të autobusëve, bulevardi Ilinden, pika lidhëse në Bit Pazarë, sheshi Kej "Dimitar Vllahov" dhe rregullimi parterë, bulevardi "Goce Dellçev", udhëkryqi afër Kombinatit të duhanit
- Ndërtimi i urave - 2.000.000 denarë
- Projekte për urat - 2.000.000 denarë

TRANSPORTI PUBLIK LOKAL, TRAMVAJI - 441.900.000 DENARË

NDËRTIMI I SISTEMEVE PËR LARGIMIN DHE PASTRIMIN E UJËRAVE TË ZEZA - 60.000.000 DENARË

VENDOSJA E PAJISJEVE URBANE - 65.000.000 DENARË

-Ndërtimi i zhardinerive nga betoni në rrugët magjistrale, furnizimi i stolave dhe shportave për mbeturinat, shtyllat mbrojtëse të gjelbërimit dhe furnizimi i kontejnerëve.

VENDOSJA E SINJALIZIMIT TË KOMUNIKACIONIT- 138.558.815 DENARË

-Qendra për udhëheqje dhe kontrollim të komunikacionit, furnizimi dhe vendosja e shenjave të komunikacionit, furnizimi i led-lanternave, aktivitete ndërtimore të semaforizimit, furnizimi i bordurave që vendosen përgjatë korsive të destinuara për autobusët, kamera dhe softuerë, furnizimi i pajisjeve dhe softuerit për smart-tiketing dhe LAA.

PARQET DHE GJELBËRIMET - 171.250.000 DENARË

- Rikonstruktimi i Parkut të qytetit (pjesa 1 dhe 2) 55.350.000 denarë, ngritja e gjelbërimit publik në rrugët magjistrale dhe rikonstruktimi i gjelbërimit urban, projekt – teatri i ri, zhardineri në lartësi, në kandelabrat, ndërtimi i bazamentit para përmendores së Goce Dellçevit, furnizimi i automjeteve dhe makinave për mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe ndarjen e fidanëve për qytetarët.

MBROJTJA E AMBIENTIT JETËSOR DHE TË NATYRËS - 53.954.685 DENARË

- Rregullimi lumit Vardar te burimi i Rashçes, rregullimi i monumentit të natyrës kanjoni Matka, realizimi i "Via ferata"- ndërtimi i korsisë për alpinizëm ekstrem në Matkë, rregullimi i shpellës Dona Duka në Saraj, rregullimi i lokalitetit të mbrojtur Gazi Baba, rregullimi dhe mbrojtja e park-pyllit Vodno, zëvendësimi çative të azbestit – çimentos.

SHPENZIME KAPITALE PËR INSTITUCIONET NGA FUSHA E KULTURËS - 94.000.000 DENARË

- Projekte për rikonstrukcion të institucioneve kulturore, rekonstrukcion të QKF, rekonstrukcion të QKM, të Sallonit 19, 19 në QIK dhe në Muzeun e Qytetit të Shkupit, përfundimin e ndërtimit të Kopshtit zoologjik me transfere të Qeverisë dhe ndërtimi dhe rikonstruktimi i Kopshtit zoologjik.

SHËRBBIME TË TJERA KOMUNALE - 20.000.000 DENARË

-Rregullimi i anës së majtë dhe të djathtë të lumit Vardar, përfundimi i azilit për qentë, furnizimi i automjeteve për shërbimin e qenve endacak, furnizimi i pajisjes për kapjen e qenve.

SPORT DHE REKREACION - 27.000.000 DENARË

-Ndërtimi i korsive për rolerë dhe biçikleta në kejin e lumit Vardar.
ARSIM I MESËM – 7.753.000 DENARË

-Projekti për rikonstrukcionin e SHMQSH "Vëllezërit Miladinov" dhe "Koço Racin", vendosje e tramëve për persona me nevojë të posaçme në shkollat e mesme dhe blerja e tajmerëve për kursimin e energjisë elektrike në shkollat e mesme.

VENDOSJA E SISTEMIT INFORMATIV GJEOGRAFIK (SIGJ) – 5.000.000 DENARË

-Mjetet e mbetura në pjesën më të madhe, rreth 800 milion denarë, përsëri janë shpërndarë për realizimin e kompetencave të interesit publik dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale dhe infrastrukturës. Pjesa e mbetur e mjeteve të parapara në vlerë prej pak më shumë se 12% është për harxhimet për administratën e qytetit.

Ky Propozim Buxhet, krahas komponentës investuese, për herë të parë në historinë e Qytetit të Shkupit, ka edhe komponentën zhvillimore, meqë projektet si tramvaji i Shkupit, SIGJ, sistemi për ujërat fekale në Aerodrom, rinovimi i rrjetit rrugor, mbrojtja e Rashçes, vendosja e sistemit për kontroll dhe menaxhim me trafikun dhe rikonstrukcionin e Parkut të qytetit janë investime afatgjata, të cilat edhe përkundër harxhimeve të mëdha kanë funksionin e zhvillimit real të resurseve të qytetit.

Qëllimi i pjesës zhvillimore është që të paraqesë planet për zhvillim, të cilat sipas karakterit janë më shumë vjeçare dhe kontribuojnë për intensivimin e zhvillimit ekonomik të Qytetit të Shkupit. Mjetet e planifikuara gjithsej për programet zhvillimore në Propozim Buxhetin janë 1.877.830.000 denarë.

Dotacione buxhetore

Krahas pjesës kryesore, Buxhetin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë edhe dotacionet e marra direkt nga Buxheti i R. të Maqedonisë. Dotacionet e marra nga pushteti qendror janë të destinuara dhe me to financohen kompetencat e fituara me procesin e decentralizimit nga fusha e arsimit, kulturës dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Nga gjithsej 1.057.224.000 denarë, 85% e mjeteve janë për paga dhe hua të të punësuarve në këto sfera kurse mbetja është për mbulimin e harxhimeve për punë. Aktivitetet programuese, modernizimi dhe një pjesë e punëve infrastrukturore të objekteve financohen nga Buxheti themelor i Qytetit të Shkupit.

Çfarë botojnë të tjerët për ne?

NËSE E ANULON “MALL RING”, GJYQI KUSHTETUES DO TA FSHIJË EDHE NDËRTESEN E SAJ



E botuar
Nova Makedonija,
12.12.2008
Autor: Aleksandra Denkovska

Plani urbanistik detal i komunës Qendër për “Mall Ring”, për të cilin Gjyqi kushtetues zhvillon procedurë për vlerësimin e ligjshmërisë të tij, parashikon ndërtimin e objektit i cili do të ndërtohet në vet gjyqin. Ai duhet të bëhet në anën e majtë të lumit Vardar afër Urrës së gurit, në hapësirë para hotelit “Stoun Brixh” dhe drejtorisë të Bankës komerciale.

Nga gjyqi njëherë e shtynë vendimin për këtë plan meqë ishte e nevojshme t’i shqyrtojnë sërish ligjet. Nga këtu konsiderojnë se edhe krahas asaj se është në interesin e tyre plani të kalojë, ajo nuk do të ndikojë në vendimin final. Ankesën e parashtroi kryetari i Qytetit Trifun Kostovski, i cili thekson se plani i thyen ligjet për qytetin e Shkupit dhe për planifikim hapësinor dhe urbanistik, si dhe me Planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit.

OBJEKT I STILIT ANTIK

Sipas paralajmërimeve, ndërtesa e Gjyqit kushtetues duhet të ndërtohet në stil antik, me shtylla të larta dhe kupola. Ajo do të ketë tetë kate dhe sipërfaqe prej rreth 12 mijë metra katror. Prej tyre, dhjetë mijë do të jenë pjesë administrative, ku do të vendosen gjyqi dhe Arkivi shtetëror, 700 metra katror hapësirë galerie, kurse 2.100 katror do të shërbejnë për parkim.

Nga shërbimi për punë të përbashkëta dhe të përgjithshme të Qeverisë, paralajmërojnë se vitin e ardhshëm duhet të sigurohen mjete

për ndërtimin e objektit dhe për atë shkak e kanë filluar procedurën për marrjen e lejes ndërtimore, përkatësisht kanë kërkuar që t’ju llogariten komunalet dhe nëse është e mundur të lirohen nga pagimi i tyre. Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski para tre ditë theksoi se komuna Qendër po bën presion që të llogaritet shuma e komunaleve, por ai nuk e ka në plan që t’i angazhojë shërbimet e tij që ta bëjnë këtë përdorim nuk ka vendim final të gjyqit për të gjithë planin. Sipas tij, ndërtesa e cila duhet të ndërtohet në anën e majtë të lumit Vardar nuk i plotëson të gjitha kushtet që të marrë leje dhe është në kundërshtim me planin e përgjithshëm urbanistik, ngaqë e tejkalon lartësinë e paraparë prej 21 metër dhe nuk është në distancë prej së paku 30 metra nga vetë shtrati i lumit.

INTERESAT E GJYQIT DUHET TË REALIZOHEN

Jugosllav Milenković, zëdhënës i Gjyqit kushtetues, thotë se ky institucion nuk niset nga interesat personale, por para së gjithash shikohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e vendimeve të sjella. Sipas tij, krejtësisht është përjashtuar varianti që të shpallet plani për “Mall Ring” për të ligjshëm vetëm që të ndërtohet ndërtesa e tyre.

-Interesat e Gjyqit kushtetues duhet të realizohen. Nëse ajo nuk bëhet me këtë plan, do të bëhet me ndonjë tjetër. Por, ne nuk jemi institucion që niset nga interesat personale. Gjyqi kushtetues vendos se a miratohet ndonjë vendim sipas rregullave të shkruara e jo në bazë të asaj se sa na konvenon neve – sqaron Milenković.

PRAKTIKA EVROPIANE

Drejt kulturës së re për mobilitet urban

“Drejt kulturës së re për mobilitet urban” është titulli i Librit të gjelbër të Komisionit Evropian (KE) që i kushtohet transportit urban. Dokumenti është miratuar më 25 shtator 2007 dhe hap debat për temat kryesore për mobilitet urban: si të përmirësohet kualiteti i transportit kolektiv si të rritet shfrytëzimi i teknologjive energjetike të pastra dhe efikase, si mund të promovohen ecja dhe çiklizmi dhe si të mbrohen të drejtat e pjesëmarrësve në transportin kolektiv.

Kaosi në komunikacionin rrugor në qytetet në Evropë është një nga problemet kryesore, i cili shkakton ndikime negative ekonomike, sociale dhe ekologjike. Nëpër qytetet evropiane, komunikacioni në rritje shkakton ngecje permanente. Eksperiencia tregon se nuk ekziston zgjidhje e veçantë për zvogëlimin e kaosit në komunikacionin rrugor.

Qëllimet e politikës transportuese evropiane nuk mund të arrihen pa kontributin e transportit urban. Për këto arsye, transporti urban është në agjendën Evropiane dhe hap kapitull të ri në politikën transportuese evropiane. Debati i madh i ngritur në BE në lidhje me këtë çështje rezultoi me propozime konkrete të përfshira në dokumentin “Libri i gjelbër për mobilitet urban”. Libri adreson sfidat kryesore të lidhura me mobilitetin urban në 5 tema kryesore: qarkullim i lirë i komunikacionit në qytete, qytete “më të gjelbra”, transport urban “më racional”, qasës, transport i sigurt për të gjithë qytetarët evropianë.

Në dokument theksohet se shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të transportit urban, përkatësisht për shpenzimet operative janë të nevojshme mjete të mëdha financiare, që përfshijnë edhe investime në infrastrukturë, terminale intermodale dhe rinovimin e parkut të automjeteve. Për financimin e suksesshëm të projekteve nga fusha e transportit urban është i nevojshëm kombinimi i instrumenteve buxhetore, rregulluese dhe financiare, duke përfshirë donacione specifike lokale dhe financim privat.

Së shpejti, Komisioni këtë dokument duhet ta operacionalizojë me plan aksionar. Në një periudhë më të gjatë kohore, përkrahja e BE-së për financimin e aktiviteteve për transport urban më të pastër do të rritet.

KOMPETENCA

KUSH PËR ÇFARË ËSHTË PËRGJEGJËS NË VEPRIMTARITË KOMUNALE (PJESA 1)

KOMUNA

Qytetarët e Shkupit shpesh kanë problem me përkufizimin e kompetencave të Qytetit dhe të komunave, kështu që nuk mund t'i detektojnë saktë organet të cilat duhet t'ua zgjidhin problemet. Redaksia "Shkupi" me qëllim që t'u ndihmojë qytetarëve, në botimet që vijojnë do t'i publikojë kompetencat dhe ingjerenat e Qytetit të Shkupit.

-ndërtim, mirëmbajtje, rikonstrukcion dhe mbrojtje e rrugëve servisuere dhe të banesave dhe objekteve të tjera infrastrukturore

- mirëmbajtja e pastërtisë së rrugëve servisuere dhe të banesave

-ndërtim dhe mirëmbajtje e ndriçimit publik të rrugëve servisuere dhe të banesave në territorin e komunës

-mirëmbajtje dhe shfrytëzim i gjelbërimit në rrugët servisuere dhe të banesave

QYTETI I SHKUPIT

-ndërtim, shfrytëzim, mbrojtje dhe mirëmbajtje e rrugëve magjistrale dhe mbledhëse dhe objekteve të tjera infrastrukturore

- kategorizim dhe emërtim i lagjeve të qytetit, rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore

-ndërtim dhe mirëmbajtje e ndriçimit publik të rrugëve magjistrale dhe mbledhëse në territorin e qytetit të Shkupit

- mirëmbajtje e pastërtisë publike të sipërfaqeve publike të komunikacionit

-mirëmbajtje e gjelbërimit të rrugëve magjistrale dhe mbledhëse

-vendosje, zëvendësim, mënjanim dhe mirëmbajtje e shenjave të komunikacionit dhe pajisjeve mbrojtëse të rrugëve lokale dhe rrugicave

-përcaktim i kushteve dhe regjimit të komunikacionit në territorin e qytetit të Shkupit

RRUGË MAGJISTRALË DHE MBLEDHËSE NË KOMPETENCAT E QYTETIT TË SHKUPIT

Bulevarde:

ASNOM, Serbia, Nikolla Karev, Goce Delçev, Makedonija, Koço Racin, Krste Misirkov, Sveti Kliment Ohridski, Ilin-den, 8 Septemvri, Makedonska vojska, Aleksandar Makedonski, Vojvodina, Makedonsko-Kosovska brigada, Hrvatska, Slovenija, Proletna Ofanziva, Krushevska Republika, Cvetan Dimov, Bosna i Hercegovina, Crna Gora, Hristijan Todorovski Karposh, Vodnjanska, Jane Sandanski, 3 Makedonska brigada, 12 Makedonska brigada, Vidoe Smilevski -Bato, Fevruarski pohod, Partizanski odredi, Kuzman Josifovski- Pitu dhe VMRO.

Rrugë:

Metodija Andonov- Çento, Saraj, 15 Korpus, Ognjan Prica (Anton Popov), Franjo Kluz, Nikolla Karev (tek Stacioni i ri i trenit), Dimo Haxhi Dimov, Bihaqaska, Vostanička, Hristo Tatarçev, Narodni heroj, Prvomajska, Samuilova, Lllazar Liçenoski, Dimitrija Çupovski, Mito Haxhivasilev-Jasmin, 11 Oktomvri, Zheleznička, Narodni front, Salvador Aljende, Zagrebska, Koce Metalec, 16

Makedonska brigada, Dimitar Vlahov, Blagoja Stefkovski, Maxhari, Shuto Orizari, Xhon Kenedi, 2 Makedonska brigada, Ferid Bajram, Kemal Sejfulla, Aleksandar Urdarevski, Butelska, Radishanska, Franklin Ruzvelt, Skupi, Nikolla Parapunov, Moskovska, Jurij Gagarin, Kozle, Pero Nakev, Bradfordska, Gjorçe Petrov, Luka Gerov, Mihail Çakov, Vasko Karangelevski, Prohor Pçinski, Serava, Lllazar Trpovski, Mitropolit Teodosij Galaganov, Marshall Tito, Dame Gruev, Vojvoda Vasil Axhilariski, Stiv Naumov, Belasica, Vasil Glavinov, Aco Shopov, Belgradska, Internacionalni brigadi, Boca Ivanova, Alekso Demnievski, 4 Juli, Sremski front, Lepenec, Tiranska, Boris Kidriç, Adolf Xhiborovski, Marko Oreshkoviç, Cetinska, Katlanovska, Bardovci, Industriska 1, Industriska 2, Dimitar Mitrev, 897, Sveti Prohor Pçinski, Romanija, Juzhna obikolnica Vodno, Ljubljanska, Inxhikovski pat (pjesë e rrugës S. Mihajlov), Vele Markov, Zhelezarska, Pere Toshev, Volkovo dhe Kruzhna Gazi Baba.

JANË NDËRTUAR 18 TRAME HYRËSE NË SHKOLLAT E MESME

Sivjet Qyteti i Shkupit ndërtoi tetëmbëdhjetë trame hyrëse në 12 shkolla të mesme në kuadër të aktiviteteve për krijimin e kushteve për përfshirjen e personave me nevoja të posaçme në procesin edukativ – arsimor. Tramet hyrëse janë vendosur në shkollat: "Nikolla Karev", "Rade Jovçevski – Korçagin", "Josip Broz Tito", "Orce Nikollov", "Koço Racin", "Georgi Dimitrov", "Vasil Antevski – Dren", "Vllado Tasevski", "Vëllezërit Miladinov", "Cvetan Dimov", "Mihajlo Pupin" dhe në "Arseni Jovkov".

Një nga prioritetet kryesore të Qytetit të Shkupit në tre vitet e fundit ishte që të sigurojë kujdes social për personat me hendikep, ta përmirësojë kualitetin e jetesës së tyre dhe të sigurojë kushte për jetë të pavarur. Është viti i tretë që organizohet transport me autobusë me dyshe të ulët për studentë dhe të rinj me hendikep nga vendi i banimit deri në fakultetet në Shkup ku studiojnë dhe deri në shtëpitë e tyre. Gjatë vitit që kaloi Qyteti dha përkrahje financiare për Qendrën ditore për përkrahjen e personave me mangësi intelektuale mbi 18 vjet – "PORAKA", me qëllim që të sigurohet funksionim, socializim dhe integrim në kontinuitet të personave me mangësi të lehta dhe të rënda në zhvillimin intelektual në vendin e banimit.

Për realizimin e këtyre projekteve, nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin 2008 u ndanë 24 milion denarë.

E.K.



Tram para gjimnazit "Josip Broz Tito"

Iniciativë

MONUMENT PËR TOSHEN NË SHESH

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski ndërmerr iniciativë për ndërtimin e monumentit-shatërvan në Sheshin Maqedonia, në pjesën e qendrore të të cilit do të dominojë figura e pop yllit maqedonas Toshe Proeski.

Monumenti-shatërvan duhet t'i ngjasojë shatërvanit të njohur të Romës Di Trevi dhe të simbolizojë – dashuri, rini, ndershmëri dhe besim, të gjithë atotribute që e karakterizojnë figurën e Proeskit.

Mendojmë se ndërtimi një monummenti të tillë që do të gjendet në sheshin qendror është në përputhje me mendimet e qytetarëve, të cilët

zgjedhën këtë vend për të shprehur respektin ndaj pop ikonës maqedonase që ndërroi jetë shumë herët.

Me rastin e kësaj iniciative Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski fton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë në bisedime dhe në të njëjtën kohë u bënë thirrje qytetarëve të qytetit të Shkupit të japin përkrahje për këtë iniciativë duke dhënë qëndrimet e tyre nëpërmjet anketës e cila do të vendoset në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk), dhe të njëjtën mund ta bëjnë edhe duke telefonuar në linjat qytetare 3297-255 ose me shkresë deri te Qyteti i Shkupit, Bulevar Ilinden B.B.

„Mital stil“ ndihmon për pastrimin e parkut

Me rastin e Ditës së punës vullnetare më 5 dhjetor këtë vit, ekipet e ndërmarrjeve publike “Higjiena Komunale” dhe “Parqet dhe gjelbërimet” së bashku me punëtorët e “Mital stil” realizuan një aksion të madh për pastrimin e Parkut të qytetit dhe të kejit të lumit Vardar. Punëtorët e dy ndërmarrjeve publike dhe pesëdhjetë punëtorë të “Mital stil” pastruan sipërfaqet prej godinës së Qeverisë deri te Parku i qytetit, përgjatë kejit të lumit Vardar. Kryetari i Qytetit të Shkupit z. Trifun Kostovski e përkrahu aksionin për pastrimin dhe i ftoi edhe kompanitë tjera me vetëdije ekologjike që të inkuadrohen në iniciativat të tilla.

Falënderime nga “POROSIA” për Qytetin e Shkupit

Qendra republikane për përkrahjen e personave me pengesa intelektuale “POROSIA” me rastin e 3 dhjetorit, Ditës ndërkombëtare për personat me invaliditet, i ndau mirënjohje Qytetit të Shkupit, në shenjë mirënjohjeje për përkrahjen në sigurimin e vazhdimësisë së punës së Qendrës ditore “POROSIA”. Qyteti i Shkupit edhe në vitin 2009 do të vazhdojë me përkrahjen e aktiviteteve të qendrës ditore.

Tenderët për shportat e mbeturinave

Në Qytetin e Shkupit në rrjedhë është procedura për zgjedhjen e ofertesit më të volitshëm për vendosjen e 300 shportave për mbeturina. Pas përfundimit të procedurës dhe pas furnizimit të shportave, ata do të vendosen përgjatë rrugëve magjistrale dhe mbledhëse të qytetit, si dhe në Parkun e qytetit.

Transportimi i autorizuar i personave me nevoja të posaçme

Që të lehtësohet realizimi i obligimeve të përditshme për personat me nevoja të posaçme, Qyteti i Shkupit gjatë viteve të kaluara e realizoi Programin për shfrytëzim të autorizuar të transportit publik urban në territorin e qytetit të Shkupit, nga ana e personave me nevoja specifike. Shfrytëzuesit e legjitimacioneve për transport të autorizuar të autobusëve janë personat me pamje të dëmtuar, me dëgjim të dëmtuar, personat me dëmtime trupore, personat me pengesa intelektuale, personat me sëmundje të veshkëve si dhe invalidët e punës, pensionistët invalidorë dhe invalidët e luftës të organizuar në shoqatat përkatëse të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit.

MAKINA TË REJA
PËR RRUGË MË TË BUKURA TË QYTETIT

Ndërmarrja publike “Rugë dhe rugica” javën e kaluar fitoi makina të reja, të cilat në masë të madhe do ta lehtësojnë mirëmbajtjen e rrugëve të qytetit. Kryetari i Qytetit të Shkupit z. Trifun Kostovski së bashku me kryetaren e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva, në kënaqësi të madhe për të punësuarit në NP “Rugët dhe rrugicat” në mënyrë simbolike i dorëzuan istikam gërryes modern, makinë për gërrishtë të asfaltit, shënues të

rrugëve dhe rrugicave, rrokullisë dhe finishues për asfaltim.

Për pajisjet, që janë dhënë për shfrytëzim të përkohshëm, Qyteti i Shkupit ndau 22 milionë denarë.

Me Vendimin e Këshillit, Qyteti i Shkupit realizoi procedurën dhe furnizoi gjashtë makina të reja ndërtimore me të cilat ndërmarrja publike do të mund të i realizojë pa pengesa projektet për rikonstrukcion të rrugëve të qytetit.

Kostovski: Uji duhet të shfrytëzohet racionalisht

Me manifestimin solemn që u mbajt në Qendrën Kulturore Rinore, përfundoi fushata e suksesshme – “H2O – burimi i jetës”, që gjatë gjashtë muajve të kaluara u realizua në 7 komuna në territorin e qytetit të Shkupit. Në fushatën për kursimin e ujit u mbajtën 7 punëtori në të cilat u diskutua për rëndësinë e ujit. Projektin të cilin e organizoi organizata joqeveritare – “Eduko Plus”, tërësisht u sponzorua prej NP “Ujësjellësi dhe kanalizimi” dhe u përkrah prej Qytetit të Shkupit.

- Shfrytëzimi i drejtë i ujit është imperativ me të cilin në të ardhmen gjithnjë e më tepër do të ballafaqohemi dhe për këtë arsye konsideroj se kjo fushatë është më se e nevojshme. Shkupi është njëri prej qyteteve të rralla në botë i cili është i privilegjuar të posedoj burimin e ujit të pijshëm në afërsi të tij, por ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike zgjojnë brengosjen në nivel më të lartë lidhur çështjen e shfrytëzimit racional të ujit – theksoi Kryetari i Qytetit të Shkupit z. Trifun Kostovski, i cili e përshëndeti këtë fushatë.

Festuesit e Kërshëndellave mblodhën degë te Krasta

Festuesit shkupjanë të Kërshëndellave të udhëhequr nga ndrikujt e sivjemë, grupi “Sintezis” fundjavën e kaluar u mblodhën në vendin e quajtur Krasta në Vodno ku edhe mblodhën degë të drurit të Kërshëndellave. Shënimi tradicional i Kërshëndellave filloi në atmosferë festive dhe bleh-muzikë. Në prerjen tradicionale të degëve të drurit të Kërshëndellave, mes të tjerëve të pranishëm ishin edhe personi i cili sivjetë ngriti dollinë, shkrimtari Venko Andonovski dhe kryebashkiaku Trifun Kostovski.



TROFTA MAQEDONASE DO TË NOTOJË NË UJËRAT E MATKËS

Qyteti i Shkupit dhe Federata e peshkatarisë maqedonase nënshkroi memorandum për përkrahjen dhe realizimin e projektit për mbrojtje, revitalizimin dhe reintrodukcionin e troftës maqedonase Salmo macedonikus (Karaman 1924) në ujërat e Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i këtij projekti është mbrojtja dhe ruajtja e llojit endemik të troftës që jeton në ujërat e Kanjonit Matka, si njëra prej komponentëve më të rëndësishme të biodiversitetit, gjithashtu edhe për fisnikërimin e ofertës turistike, zhvillimit të peshkatarisë rekreative dhe sportive.

Realizimi i projektit do të financohet nga Qyteti i Shkupit (100.000 denarë), Fondi global ekologjik (299.710 denarë), Instituti për blegtori – Seksioni për peshkatari (86.000 denarë) dhe

Federata maqedonase e peshkatarisë (135.000 denarë).

Trofta maqedonase - Salmo macedonikus paraqet një lloj autokton endemik të peshkut dhe është pjesë e biodiversitetit të pasur në vendin tonë. Gjendet në listën e kuqe të IUCN dhe për të ka vetëm pak të dhëna të disponueshme. Për momentin trofta maqedonase është e përfaqësuar vetëm në ujërat e Beliçka dhe Malla Reka (degë të lumit Treska).

Me realizimin e projektit i cili do të realizohet me iniciativë të Seksionit për turizëm pranë Qytetit të Shkupit, me ç'rast do të shtohet numri i popullatës së re të troftës maqedonase për shtimin e peshqve në Malla Reka, Beliçka Reka, në lumin Treska dhe akumulimet e Kozjakut, Matkë dhe Shën Petka.

A.XH.



U RENOVUAN TABELAT E DËMTUARA INFORMATIVE

Qyteti i Shkupit i renovoit tabelat e dëmtuara informative “Sinjalizimi” që janë vendosur në më shumë lokacione të qytetit dhe të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme për monumentet kulturore – historike në qytetin e Shkupit.

Këto tabela janë pjesë e projektit francez – maqedonas, që udhëhiqet nga ana profesionistëve nga Maqedonia dhe nga qyteti francez Anguleme. Qyteti i Shkupit vitin e kaluar realizoi kontrollimin e gjendjes së këtyre tabelave dhe gjatë kësaj konstatoi se pjesa më e madhe e tyre janë të tërësisht të shkatërruara nga ana e qytetarëve të pandërgjegjshëm. U soll vendimi se nevojitet zëvendësimi urgjent i tyre, riparimi dhe adaptimi i sërishëm i 18 tabelave sinjalizuese.

Këto tabela janë të vendosura në lokacione atraktive në pjesën qendrore të qytetit dhe të njëjtat shërbejnë si udhëheqës turistik të cilat e rrëfejnë historinë e migrimeve në qytetin e Shkupit

dhe i prezantojnë tërësitë urbanistike dhe momentet e historisë së qytetit të Shkupit. Ata përmbajnë informacione për lagjet e vjetra, Shtëpinë e armatës, urat e vjetra dhe objektet tjera që janë të rënuara dhe të cilat mund të gjenen si fotopërshkrime në arkivat dhe muzeumet.

Tabelat që janë në formë të pulteve informative, pllakave dhe shtyllave, ata janë të vendosura në sheshin “Makedonija”, në dyja anët e kejit të lumit Vardar, në urën “Goce Dellçev”, rrugën “Makedonija”, Kalanë e Shkupit dhe Çarshinë e vjetër të Shkupit.

Qyteti i Shkupit apelon deri te qytetarët që mos t'i dëmtojnë tabelat informative për arsye se të njëjtat jo vetëm që ofrojnë një pamje të posaçme estetike për qytetin por ato paraqesin edhe informues të rëndësishëm turistik.

A.XH.

Tribuna

“PLANIFIKIMI URBANISTIK DHE VENDI I QYTETIT TË SHKUPIT NË SISTEMIN E VETËQEVERISJES LOKALE”

Në organizim të Fakultetit arkitektonik, këto ditë, u mbajt tribunë me temë “Planifikimi urbanistik dhe vendi i Qytetit të Shkupit në vetëqeverisjen lokale”. Tribunën e hapi dekani i Fakultetit arkitektonik, Vlatko Korobar, kurse në debat morën pjesë profesorë me renome nga fusha e arkitekturës dhe urbanizmit, të cilët nga aspekti shkencor i elaboruan problemet me të cilat Qyteti i Shkupit përballët në sferën e planifikimit urbanistik, si dhe problemet në relacion pushtet qendror – vetëqeverisje lokale.

Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski në fillim të tribunës përsëri theksoi nevojën për reforma në organizimin dhe funksionimin e kryeqytetit.

– Mund të them një mijë shkaqe se pse Shkupit nuk i përshtatet ky organizim territorial, por asnjë se i përgjigjet përveç politikës – deklaroi Kostovski.

Profesori Mirosllav Grčev vlerësoi se vetëqeverisja lokale nuk mund të funksionojë me ligjet ekzistuese,

megjenëse vetëqeverisja lokale nuk ka as pronësi, e as kompetenca të vërteta.

– Vetëqeverisja lokale është invalid, i varur nga vullneti politik e pushteti qendror- theksoi Grčev, në këtë kontekst, ai theksoi se Qyteti duhet ta posedojë dhe të udhëheqë me infrastrukturën e qytetit.

Në tribunë u prezantuan edhe konkluzionet e projektit shkencor “Roli dhe kompetencat e pushtetit qendror dhe lokal në sistemin e planifikimit urban” në pjesën e Qytetit të Shkupit. Konkluzionet tregojnë se e gjithë përfshirja planifikuese e Planit të përgjithshëm urbanistik për Shkupin nuk është përpunuar bashkë me Planin urbanistik detal, si dhe atë që komunat në kuadër të Shkupit nuk i kushtojnë vëmendje të veçantë planifikimit urban nga aspekti i buxheteve për planifikim, zhvillimi dhe ekipim urban të sektorëve për planifikim urban, mos pasja e trupave kompetente për realizimin e planeve, numri jo i mjaftueshëm i inspektorëve

urban dhe kontrolleve të kryera si dhe mos ekzistimi i trupave të përbashkëta mes komunave për bashkëpunim në këtë fushë.

Tribuna u përqendrua në dy aspekte, modeli organizues i qytetit dhe mënyra me të cilën ai pasqyrohet në sferën e planifikimit urbanistik, si një nga kompetencat themelore të vetëqeverisjes lokale. Në tribunë u vlerësua se organizimi aktual territorial është jo adekuat dhe i tejkaluar për Shkupin. Nga këtë shkaqe, Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski inicioi sjelljen e Ligjit të ri për Qytetin e Shkupit në të cilin do të përcaktohen kufijtë dhe do të determinohen të ardhurat e qytetit. Me ligjin e ri Shkupi do të duhej të organizohet si qytet me një komunë dhe kuarste, distrikte dhe bashkësi vendore të cilat do të jenë nën juridiksionin e qytetit, me çka do të tejkalohet dublimi i kompetencave dhe bllokimi i projekteve.

T.S.



Sa është Shkupi qytet i qëndrueshëm ?

„Shkupi -Qyteti i qëndrueshëm” është titulli i tribunës organizuar nga Qyteti i Shkupit dhe Forumi i OJQ-ve të Qytetit të Shkupit, që u mbajt në Muzeun e Qytetit të Shkupit. Në tribunë ekspertë nga fushat e urbanizmit, ekologjisë dhe transportit folën për mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm të Qytetit të Shkupit. Profesori nga Fakulteti arkitektonik, Tihomir Stojkov foli për perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Qytetit të Shkupit. Menka Spirovska prej Shoqatës për konsalting ekologjik “DEKONS EMA” prezantoi shembuj për qytete të qëndrueshme. Përfaqësuesja e Ministrisë për ambient jetësor dhe mbrojtje të natyrës, Lile Riskova informoi për aktivitetet e ndërmarra në planin hapësinor për regjionin e Shkupit. Përfaqësuesi prej “IMPUMA”, Stefan Kalajgijski mbajti prezentim interesant në temën “Koncepte të reja në transportin e qëndrueshëm urban”. Pas interpretimeve të ekspertëve u hap diskutimi për mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit të Shkupit, me çrast u konstatua se Shkupi ka parakushte të bëhet qytet i qëndrueshëm.

Ndërmarrja e qarkullimit publik "Shkup"

PËR TRANSPORT PUBLIK MË CILËSORË ËSHTË E DOMOSDOSHME PËRKRAHJA MË E MADHE NGA ANA E SHTETIT

Elena Kuzmanovska

Parku i vjetër vozitës, borxhi joreal financiar ndaj shtetit i cili daton qysh prej vitit 1997 dhe ekonomia e zezë janë vetëm një pjesë e problemeve me të cilat ballafaqohet me vite të tëra Ndërmarrja e qarkullimit publik "Shkup". Për funksionalizim normal të ndërmarrjes publike dhe për avancimin e transportit urban të udhëtarëve nevojitet përkrahja e shtetit, sipas shembullit të qyteteve evropiane, përkujton Aleksandar Boshkoviç, drejtor i NQP.

- Këtë vit për herë të parë pas 60 viteve të ekzistimit të Ndërmarrjes së qarkullimit publik "Shkup", fitojmë subvencione nga ana e Qytetit të Shkupit në vlerë prej 140 milionë denarë. Kjo iniciativë e Kryetarit të Qytetit z. Trifun Kostovski, të cilën e përkrahu edhe Këshilli, është për t'u përshëndetur. Ne jemi ndërmarrja e vetme publike e cila vetëfinancohet. Në të gjitha qytetet evropiane, transporti publik urban është i subvencionuar si nga pushtet lokalë ashtu edhe nga shteti. Mendoj se është me rëndësi tejet të madhe që një gjë e tillë të praktikohet edhe te ne – sqaron Boshkoviç.

Ai thekson se është për t'u përshëndetur ideja e z. Kostovskit për vënien e korsive të verdha në rrugët dhe bulevardet në të cilat qarkullojnë autobusët e NQP që të lehtësohet lëvizja e tyre, si dhe implementimi i smart-tiketingut dhe lokalizimit automatik të automjeteve.

- Me rëndësi të madhe është edhe zgjidhja e problemeve me stacionet e autobusëve të cilat duhet të furnizohen me pajisje urbane dhe të mbulohen, ata duhet të furnizohen edhe me informues preciz për orarin e autobusëve – shton Boshkoviç.

Kryetari Trifun Kostovski prej fillimit të mandatit të tij ngriti më shumë iniciativë për modernizimin dhe përtëritjen e parkut vozitës të NQP "Shkup". Në fund të vitit 2005 Qyteti i Shkupit u inkuadrua në programin "OPET" të Ministrisë për punë të jashtme të Holandës. Me programin ishte paraparë që t'i ndihmohet NQP me një linjë të volitshme kreditore që të

furnizojë 100 autobusë të ri prej të firmës TAF. Qeveria holandeze siguroi edhe 35 % lirim për pakon kreditore, që do të thotë se huazimi kreditor për NQP do të ishte rreth 65% nga vlera e përgjithshme e autobusëve të ri. Qyteti i Shkupit ishte i gatshëm të bëhet garantues i kredisë. Iniciativën e dytë Kryetari Kostovski e parashtrori në gjysmën e dytë të vitit 2006 me Bankën evropiane për përtëritje dhe zhvillim (EBRD). Iniciativa u inaugurua me nënshkrimin e Letrës mandatore për projektin për komunikacionin urban në qytetin e Shkupit. Përveç përtëritjes së parkut vozitës të NQP, u parashikua edhe financimin e programit për zhvillim korporativ të ndërmarrjes publike, implementimi i strategjisë për transport publik në qytetin e Shkupit si dhe shqyrtimin e nevojave për përmirësimin e rregullativës për transportin publik. Me këtë projekt EBRD duhet ta lejojë hua prej 12 milion euro për blerjen e 100 autobusëve solo me dysheme të ulët me klasë të motorit EURO 4. Ministria përgjegjëse i refuzoi të dy kërkesat.

Në dhjetor 2007, Qeveria solli vendim që NQP t'i japë donacion prej 4,4 milion euro për blerjen e 45 deri në 50 autobusëve të rinj. Në pajtim me këtë vendim, u formua komisioni për realizimin e furnizimit publik të autobusëve. Këshilli drejtues i NQP më 11 qershor solli vendim për furnizim publik të 50 autobusëve për transport publik të udhëtarëve. Vendimi i KD, kishte të bëjë me 45 autobusët e rinj solo me dysheme të ulët, klasa e motorit minimum EURO 4, katër autobusë dykatësh solo të përdorur, me klasë të motorit minimum EURO 3 dhe një autobus solo të përdorur dykatësh panoramik (i hapur në katin e sipërm) me klasë të motorit minimum EURO 3. Në bazë të këtij Vendimi NQP shpalli thirrje publike për furnizimin me 50 autobusë, drejtori i mëparshëm Orce Georgievski, gjashtë ditë para skadimit të afatit për dorëzim, e anuloi furnizimin publik. Këshilli drejtues i NQP solli vendim për furnizimin e 52 autobusëve, prej të cilëve 50 solo autobusë të rinj me dysheme të ulët

dhe dy solo autobusë të rinj dykatësh panoramik. Në tenderin ndërkombëtar, arritën 29 oferta nga prodhues vendas dhe të huaj të autobusëve kurse realizimi i procedurës e kushtoi NQP 108.858 denarë.

Pas anulimit të tenderit, NQP i ktheu mjetet e dhëna nga Qeveria.



Shëtitja promovuese me autobus me dysheme të ulët

Kryetari Kostovski, me qëllim që t'i tregojë Qeverisë se vendimi primar për furnizimin me autobusë me dysheme të ulët është vendim i vërtetë për problemin me transportin publik të qytetit, organizoi edhe shëtitje promovuese me autobus të rinj me dysheme të ulët të firmës Mercedes. Reagimet e qytetarëve, të cilët kishin mundësi të shëtitën me autobusin e ri mercedes, ishin më shumë se pozitive.

FORTESA KALE – FILLIMI I SHKUPIT MODERN

Kalaja që ekziston edhe sot është ndërtuar në shek. e 6-të. Sipas arkeologëve, blloqet e gurit me të cilat është ndërtuar Kalaja janë marrë nga qyteti i rrënuar Skupi. Kalaja e Shkupit padyshim është një nga monumentet më të rëndësishme historike në vendin tonë.

Tome Smilevski

Shekuj me radhë pushtues të ndryshëm e kanë ndërtuar, rrënuar dhe rindërtuar, por kalaja qëndron dhe vazhdon të jetë simbol i shpirtit të panënshtuar të popullit në këto troje. Kalaja e Shkupit është një nga vendet më të bukura të qytetit, që ofron një pamje magjike të qendrës së qytetit. Kalaja qëndron në kodrën e lartë të njohur me emrin Gradishte dhe nëpër histori ka pasur rëndësi të madhe strategjike për qytetin.

Përjetësia dhe mistika e Kalasë së Shkupit është vërtetuar me gërmimet e deritanishme arkeologjike në lokalitet, që tregojnë të kaluarën parahistorike të saj. Gjetjet tregojnë se banorët më të hershëm të njohur në këtë vend kanë jetuar në periudhën e neolitit dhe periudhën e bronzit të hershëm, 4000 vjet p.e.s.

Kalaja e Shkupit ka formë trekëndëshi, nga sipëri rrafshët dhe me pjerrësi të madhe në pjesën jugore

dhe atë perëndimore. Pjesa lindore zbret në mënyrë të shkallëzuar drejt Fushës së Shkupit dhe drejt lumit të dikurshëm Serava dhe në të gjendet një pjesë e Çarshisë së vjetër. Pjesa veriore është e lidhur me kodrat që janë pjesë përbërëse e rrëzës së Malit të Zi të Shkupit. Bëhet fjalë për një terren të mbrojtur në mënyrë natyrale dhe të pakalueshëm lehtë, i cili që në kohët e hershme ka qenë i volitshëm për banim. Nga ana perëndimore e kalasë rrjedh lumi i Vardarit. Në atë anë ka një rrugë që të çon nga qyteti anës shpellave drejt “Vodenite kuli” që gjenden në bregun e lumit. Në anën lindore, juglindore dhe veriore të qytetit gjendet një kanal i thellë prej shkëmbinjsh të thepisur. Në atë anë, para portës, gjendet urë druri mbi kanal. Rojet, sipas të dhënave historike, e ngrinin urën me çikrik dhe në atë mënyrë bënë një digë para portës së tyre.

Kalaja që ekziston edhe në ditët e sotme është ndërtuar në shek. e 6-të. Sipas arkeologëve, blloqet e gurit me të cilat është ndërtuar Kalaja janë marrë nga

qyteti i rrënuar Skupi. Supozohet se në shek e 6-të dhe të 7-të këtu ka qenë ndërtuar qyteti i Bizantit të hershëm, Justinijana Prima, që ka qenë qendër administrative e Ballkanit. Sipas profesor Mikulçiq, Kalaja është gjallëruar sërish në shek e 10-të, kur në kohën e Car Samuil it është formuar qyteti bizantin-sllav i mesjetës, i cili në suazat e Mbretërisë së gjerë maqedonase të Samuil it, përbënte një nga pikat më të rëndësishme - qytete - kala. Gjatë kohës së Perandorisë Islame Kalaja e Shkupit ka qenë objekt luftarak.

Tërmeti katastrofal i vitit 1963 i solli dëme shumë të mëdha kalasë. U rrënuan fortifikimet, kullat mbrojtëse, si dhe ndërtesat që gjendeshin në kala. Pas tërmetit, filloi një aksion i madh për restaurimin dhe konservimin e kalasë, por dëmet nuk janë sanuar plotësisht.

Kalaja e Shkupit padyshim është një nga monumentet më të rëndësishme të vendit tonë.



Qytete të vëllazëruara – Nirnbergu

METROPOL – KU JANË TË PËRZIERA E KALUARA DHE MODERNIA

I vendosur në dy brigjet e lumit Pegnic, qyteti Nirnberg është përzierje unike e periudhës tradicionale dhe moderne. Nirnbergu është qytet modern me 500.000 banorë, por në panoramën e qytetit ende dominojnë histori të lashta mijëra vjet.

Nirnbergu është qyteti i dytë sipas madhësisë në Bavari dhe komuna e 14 sipas madhësisë në Gjermani. Ai është qendër ekonomike, shërbyese dhe kulturore e Bavarisë Veriore. Në të jeton më shumë se 18 përqind e popullsisë të përkatësive tjera përveç gjermanëve. Të gjithë banorët e Bavarisë jetojnë në tolerancë dhe koegzistencë të qetë, shkruhet në faqen zyrtare të faqes së internetit.

Qyteti shtrihet në sipërfaqe prej 186,6 kilometra katror. Në perëndim, Nirnbergu lidhet me komunat fqinje Furt dhe Zindorf, kurse në jug me qytetet Stajn dhe Oberasbah. Nirnberg është i vjetër rreth 1000 vjet. Në mesjetë, në Nirnberg është mbrojtur kurora mbretërore e perandorisë. Në shekullin 20 qyteti u bë qendër e nazizmit, kurse pas përfundimit të Luftës së dytë botërore këtu janë zhvilluar gjykimet e njohura të kriminelëve më të mëdhenj të luftës së regjimit nazist.

Nga bombardimet qyteti u shkatërrua shumë, por sot ai paraqet përzierje të suksesshme të jetës në të kaluarën dhe të kohës moderne. Nga vitit 1970 e këtij Nirnbergu transformohet në qendër serviseuse me shkallë të lartë në fushën e serviseve inovative, inxhinierive, konsultimeve ekonomike, hulumtimeve të tregut dhe E- biznesit.

Nirnbergun çdo vjet e vizitojnë më shumë se 1,2 milion turistë të cilit marrin pjesë në rreth 100 ngjarje dhe rreth pesëdhjetë panairë dhe kongrese, duke përfshirë edhe panairin më të madh të specializuar për lodra në botë. Nirnbergu ofron paletë ngjarjesh për të gjitha shijet nëpër gjithë vitin, operë, balet në Tetarin shtetërore, ngjarje kulturore për fëmijë, kabare, festivale dhe koncerte muzikore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar me qytete tjera daton që nga mesjeta. Këto lidhje në shkallë më të madhe kanë ndikuar në zhvillimin e “Qytetit të lirë të Perandorisë” të mëparshme. Qyteti sot mban lidhje të shkëlqyera me 14 qytete të vëllazëruara të të gjithë botës, mes të cilave edhe me Shkupin.

E.K.

SHKUPI VËLLAZËROHET ME SARAGOSËN



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski dhe Kryebashkiaku i qytetit spanjoll Saragosa, Huan Alberto Beloç, më 11 dhjetor të këtij viti, nënshkruan Marrëveshje për vëllazërim me të cilën u zyrtarizua fillimi i bashkëpunimit ndërmjet dy qyteteve.

Në bazë të bisedimeve dhe marrëveshjes, pritet Shkupi dhe Saragosa të fillojnë me aktivitetet e lidhura me realizimin e projekteve në shumë fusha, që janë përfshirë në Marrëveshjen për vëllazërim. Të dy qytetet janë për fuqizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore dhe promovimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes për qytetarët e Saragosës dhe Shkupit.

Të dy qytetet do të këmbëjnë informata dhe eksperiencë dhe do të stimulojnë bashkëpunimin në fusha të ndryshme të veprimit që janë në kompetencat e qyteteve dhe veçanërisht në fushat e: menaxhimit me qytetin dhe shërbimet publike; turizmit; urbanizmit; mbrojtjes së ambientit jetësor; arsimit dhe kulturës; sportit; bashkëpunimit të organizatave të të rinjve dhe jo-qeveritare; bashkëpunimit në suazat e rrjeteve të qyteteve anëtarë të të cilave janë të dy qytetet; në çështjet evropiane dhe në sferat e kompetencave të vetëqeverisjes lokale. Me Marrëveshjen për vëllazërim, të dy qytetet obligohen t'i kushtojnë vëmendje të veçantë këmbimit të eksperiencave dhe praktikave të mira dhe do të këmbëjnë informata për projekte dhe do të marrin pjesë në projekte me interes të përbashkët.

Qyteti i Saragosës gjendet në brigjet e lumit Ebro dhe ka 680.000 banorë, përafërsisht sa Shkupi. Në qytet gjendet bazilika e njohur katolike Nuestra Senora Del Pilar dhe katedralja Del Salvador.

A.XH.



Bazar për Kërshëndellat në Nirnberg

QYTETI I SHKUPIT

Kryetari i Qytetit të Shkupit
TRIFUN KOSTOVSKI
tel: 3 297 204
gradonacalnik@skopje.gov.mk
baraka nr: 4

Sekretari i Qytetit të Shkupit
LJUBISHA GEORGIEVSKI
tel: 3 297 281, 3 297215
baraka nr: 3

Kryetari i Këshillit të Qytetit të Shkupit
IRENA MISHEVA
tel: 3 297 207
irena.miseva@skopje.gov.mk
baraka nr. 1

Sektori për financa
Drejtues: Kërste Anadonovski
tel: 3 297 277
kandonovski@skopje.gov.mk
baraka nr: 7

Seksioni për përcaktimin dhe pagimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve tjera
Drejtues: Andrijana Mañevska
tel: 3 297 275
andrijanam@skopje.gov.mk
danoci@skopje.gov.mk

•SEKTORI PËR MBROJTJEN E AMBI-
ENTIT JETËSOR DHE TË NATYRËS
Udhëheqës: Cvetanka Ikonomova -
Martinovka
tel: 3 297 301, baraka nr: 14
Cvetanka.Ikonomova@skopje.gov.
mk
infoekologija@skopje.gov.mk

•SEKTORI PËR PUNË KOMUNALE
Udhëheqës: v.d Jelena Perinska
tel: 3 297 392, baraka nr: 11
Jelena.Perinska@skopje.gov.mk

Inspektorati i Qytetit të Shkupit
Drejtues: Hamzi Xhaferi
tel: 3 297 359
hamzidz@skopje.gov.mk
baraka nr: 14

NDËRMARRJET PUBLIKE

NP "Parkingu i qytetit"
Drejtor: Ljupço Jovanov
jovanovlj@gradskiparkig.com.mk
tel: 3091 072 , 3091 074
www.gradskiparking.com.mk

Shërbimi i merimangës
tel: 3 238 871

NP "Rrugë dhe rrugica"
Drejtor: Ilija Martinovski
tel: 3 162 317

www.jpuliciipatista.com.mk
NQP "Shkup"
Drejtor: Alaksandar Boshkoviç
aboskovic@jsp.com.mk
tel: 3 174 265
www.jsp.com.mk

Qendra e dispeçerisë:
tel: 3 173 224

NP "Higjiena komunale"
Drejtor: Zlatko Dimovski
tel: 3 220 827
www.khigiena.com.mk

NP "Parqet dhe gjelbërimet"
Drejtor: Dushan Aviroviç
tel: 3 070 112

NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi"
Drejtor: Igor Arnaudov
tel: 3 220 839
www.vodovod-skopje.com.mk

Rajonet për pagesë dhe mirëm-
bajtje të rrjetit të ujësjellësit dhe
kanalizimit

Rajoni 1 – Qendër
pagesa tel: 3 117 753
reoncentar@vodovod-skopje.com.
mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 238 992
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 137 123

Rajoni 2 – Kisella Voda
pagesa tel: 3 116 987
reonkiselavoda@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 2 782 609
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 2 791 566

Rajoni 3 – Karposh
pagesa tel: 3 118 581
reonkarposh@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 076 407
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 062 174

Rajoni 4 – Çair
pagesa tel: 3 117 673
reoncair@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 2 671 888
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 2 671 999

Rajoni 5 – Gazi Babë
pagesa tel: 3 116 889
reongazibaba@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 174 524
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 174 524

INSTITUCIONET KULTURORE TË
QYTETIT

- Biblioteka „Vëllezërit Milladinov“
3162-544
- Qendra informative kulturore
3115-238
- Shtëpia e kulturës „Koço Racin“
3163-739
- Qendra kulturore rinore 3115508
- Muzeumi i qytetit të Shkupit
3115-367; 3113-609
- Salla Univerzale-Shkup 3245615
- Kopshti zoologjik 3220-578
- Qendra kulturore e fëmijëve
„KARPOSH“ 3116-159

NUMRAT MË TË RËNDËSISHËM

- Shërbimi i zjarrfikësve 193
- Qendra për menaxhimin me krizat
195
- Elektro-Shkup 02 3161454
- Ngrohtorja 02 3076200
- Qendra urgjente 02 3147147
- Spitali i qytetit 02 3130311
- Aeroporti „Aleksandar Makedon-
ski“ 02 3148333; 02 3148336
- Stacioni ndërkombëtarë i auto-
busëve 02 2466011; 02 2466313
- Stacioni hekurudhor 02 3164255
- Shërbimi amë - DQPM 3117 037;
3117 766
- Salla e kurorëzimeve 3118 250
- Inspektorati republikan i tregut
975
- SOS – gjendjet e krizës për fëmijët
dhe të rinjtë 0800 12 222; 3136 400
- SOS – për gratë dhe fëmijët vik-
tima të dhunës 9700
- SOS – informata dhe parandalimi
i tregtisë me njerës 0800 11 111;
3173 424
- Teatri dramatik 3063388
- Qendra teatrale e fëmijëve
3290111
- Opera dhe baleti maqedonas -
OBM 3114511
- Galeria kombëtare e Maqedonisë-
Stacioni i vogël 3126856

KOMUNAT E SHKUPIT

- Komuna Qendër 3203 680
- Komuna Kisella Voda 2785 400
- Komuna Aerodrom 2400 970
- Komuna Karposh 3061 507
- Komuna Gazi Babë 3226 655
- Komuna Çair 2616 865
- Komuna Butel 2616 868
- Komuna Shuto Orizare 2650 584
- Komuna Gjorçe Petrov 2039 307
- Komuna Saraj 2050 289



ГРАД СКОПЈЕ
ОПШТИНА ШКУПЈЕ

FROM
SWEDEN

ARRIVAL

THE MUSIC OF ABBA

.....T.....



31.12 sheshi"Maqedonia"- fillimi 21,00

Pritja e Vitit të Ri